



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

# **KURRIKULA ME ZGJEDHJE**

**LËNDA: TEATËR**

**KLASA: X**

Tiranë, 2016



## PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

I.Hyrje .....	3
II. Korniza konceptuale e programit.....	6
II.1.Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit.....	7
II.2.Qëllimet e APU .....	8
II.3.Qëllimet e programit të teatrit .....	9
II.4. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës.....	10
II.4.1. Diagrami 2: Rezultatet kryesore të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së teatrit për shkallën e pestë .....	13
II.5.Lidhja e lëndës së teatrit me temat ndërkurrikulare .....	14
II.5.1. Diagrami 3: Lidhja ndërmjet teatrit dhe fushave të tjera .....	16
II.6. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj .....	17
II.6.1 Diagrami 4 : Kompetencat që formohen përmes tematikave.....	18
II.6.2. Tabela 1: Kompetencat e veçanta dhe përshkrimi i tyre .....	19
II.7. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë .....	20
II.7.1 Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	20
III. Përmbajtja e shkallës së pestë .....	21
III.1 Rezultatet e të nxëniet të kompetencave, sipas tematikave, sipas shkallëve - shkalla e pestë: klasa e dhjetë .....	22
III.1.1. Tematika: Gjuha dhe komunikimi teatror.....	22
III.1.2. Tematika: Teknika dhe procese teatrore .....	25
III.1.3. Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria.....	28
IV. Udhëzime metodologjike.....	33
V. Udhëzime për vlerësimin .....	35
VI. Materiale dhe burime mësimore .....	36

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës dhe pjesë integrale e jetës sonë të përditshme, ku në të përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, në të cilën ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Artet dhe studimi i tyre zhvillon njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër të cilat lidhen ngushtë dhe ndihmojnë në zhvillimin intelektual, emocional, social dhe kulturor të nxënësve nga parashkollori deri në arsimin e mesëm të lartë.

Nëpërmjet përjetimit, vëzhgimit, krijimit, vlerësimit, artet mundësojnë t'u jepet kuptim ideve dhe të komunikohet nëpërmjet krijimeve artistike. Gjuha artistike dhe veprat e artit, të veshura me vlera sociale dhe kulturore të jetës së përditshme, kontribuojnë në zhvillimin e këtyre vlerave dhe pasqyrojnë historinë dhe shoqërinë njerëzore. Gjithashtu, artet luajnë një rol të rëndësishëm në shprehjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore të shoqërisë dhe në zhvillimin, afirmimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor dhe atij kombëtar.

Artet përfshijnë artin pamor, muzikën, teatrin dhe kërcimin, në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm të lartë, pikërisht në *shkallën e pestë* dhe në *shkallën e gjashtë*.

Kurrikula e arteve<sup>1</sup> në *shkallën e pestë* dhe *të gjashtë*, fokusohet në zgjerimin e njohurive artistike dhe zhvillimin e tyre në përdorimin dhe zbatimin e gjuhës artistike. Nxënësit krijojnë, performojnë/realizojnë dhe vlerësojnë artet duke krijuar gjykime dhe qëndrime të qarta në klasë, përmes punëve të veta apo të autorëve të ndryshëm dhe zhvillimit historik, duke krijuar kompetenca të qëndrueshme dhe të zbatueshme në këto disiplina artistike.

---

<sup>1</sup>Artet, zhvillohen në kurrikulën me zgjedhje të detyrueshme, për shkallën e pestë dhe të gjashtë të arsimit të mesëm të lartë përmes katër lëndëve: art pamor, muzikë, teatër dhe kërcim.

## I.Hyrje

Teatri është një nga artet më të vjetra në botë dhe, sado që deri në fillim të shekullit të shkuar është parë si një art që përmblihte bashkë fjalën e interpretuar, muzikën, artet pamore dhe të tjera elemente artistike, antropologët dhe shkollat moderne të teatrit e shohin gjithmonë e më shumë këtë gjini artistike si një rrjedhojë të natyrshme njerëzore, e cila buron drejtpërsëdrejti nga rituali. Njeriu ka një nevojë të brendshme që e çon drejt teatrit, sepse ai ka nevojë të krijojë art me trupin e zërin e tij dhe një realitet artistik ku të shfaqë probleme madhore si një mjet spastrimi ose argëtimi të mirëfilltë; ai ka nevojë ta shohë botën me sytë e tjetrit dhe të shpërndajë mesazhe përmes fjalës së përpunuar artistike. Teatri ka qenë gjithmonë i lidhur ngushtë me zhvillimin njerëzor, në cilëndo fazë të zhvillimit shoqëror apo në çfarëdo terreni kulturor. Ai gjithmonë ka qenë pjesë e proceseve historike, duke u lidhur ngushtë me politikën, filozofinë, psikologjinë dhe artet e epokave të ndryshme historike.

Këto tipare të teatrit e bëjnë atë të jetë sa i natyrshëm për të gjithë, aq edhe i ndërlikuar kur është në formën e tij më të zhvilluar, ndaj kur ndërthuret me proceset e arsimit është një ndihmë e madhe për kulturën e secilit individ dhe të shoqërisë në përgjithësi. Një nxënës që e njeh teatrin di ta vlerësojë dhe do ta vlerësojë atë edhe në të ardhmen, ai është në gjendje të marrë mesazhet e duhura dhe emocione të plota kur ndjek një shfaqje, madje një takim që në vogëli me teatrin ndez në individë të caktuar edhe dëshirën për t'u bërë pjesë aktive e teatrit, në një kohë kur kjo prirje zor se nxitet tek të rinjtë, përveçse nga familja.

Njohja e teatrit mbart një vlerë të madhe në zhvillimin e personalitetit të nxënësve, të aftësisë së tyre për të punuar në grup, për të konsideruar mënyrën si e sheh botën tjetri, për të folur në mënyrë të denjë në publik dhe për të zhvilluar prirjet e tyre artistike, krijuese e kritike. Vazhdimi i rrugëtimit të njohjes me teatrin është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, të aftësive të tyre për të dëgjuar në mënyrë të pavarur e sistematike vepra të ndryshme teatrore si dhe për të menduar dhe gjykuar në mënyrë kritike rreth tyre.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është lidhja e teatrit me të gjitha lëndët e tjera brenda fushës së arteve dhe fushat e tjera të kurrikulës, si dhe me temat ndërkurrikulare, me qëllim që të zotërohen sa më mirë kompetencat kyçe. Teatri është emëruesi i përbashkët i një sërë

elementesh artistike: letërsisë (lënda që interpretohet), pikturës (skenografi, kostume), muzikës, ndriçimit, imazheve pamore, etj. Për këtë arsye ka nevojë për marrjen e disa njohurive themelore që lidhen me këto elemente dhe me tipare të tjera të veçanta të interpretimit artistik, duke i bërë nxënësit të vetëdijshëm për këtë gjini artistike dhe duke zgjeruar njohuritë e tyre.

Veprimtaritë e ndryshme teatrore e çojnë nxënësin të interpretojë teknikisht e me shije materiale të ndryshme letrare, të përdorë aftësitë e tij fizike e krijuese për të përcjellë mesazhe, për të krijuar karaktere dhe realitete artistike që ngrihen në një shkallë më lart se realiteti.

Teatri, duke qenë specifik, kërkon disa dije bazë për ta kuptuar dhe shijuar. Pas dijeve fillestare të marra në shkollë të hershme, tani adoleshenti nuk e zgjedh më teatrin si lojë, por si një nevojë të brendshme që e çon drejt pasioneve të tij skenike, të cilat janë thelluar më shumë tek ai që e ka pasur edhe më herët për zemër këtë gjini. Adoleshenti përforcon konceptet bazë si përqëndrimi, artikulimi i fjalëve, fuqia bindëse e tyre (oratoria dhe të folurit publik), besimi në lojë si aktor, hapësira artistike, fuqia artistike për të përcjellë mesazhe dhe për shpalosur atë që kemi brenda vetes, konvencioni artistik. Duke e përjetuar teatrin nga vetë skena, ai do ta çojë më tej kënaqësinë që merr prej teatrit dhe do të ketë një gjykim kritik ndaj punëve skenike, që do të shohë në të ardhmen.

Lënda e teatrit synon t'i edukojë dhe formojë nxënësit nga pikëpamja teatrore duke i orientuar ata nëpërmjet vetëzbulimit drejt kuptimit të veçorive të gjinisë teatrore nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, përmes gjuhës dhe tipareve të komunikimit teatror, por edhe duke marrë pjesë individualisht e në grup në realizimin e veprave teatrore<sup>2</sup>, për të krijuar vlerësimin dhe qëndrimin artistik në njohjen e teatrit shqiptar dhe botëror përmes materialeve të ndryshme të interpretueshme.

Mësimi i teatrit në shkollë lidhet me njohjen, të kuptuarit dhe zbatimin e koncepteve e teknikave të teatrit dhe interpretimit të fjalës. Teatri në shkollë lidhet jo vetëm me zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive, por është edhe një mënyrë të menduari e të vlerësuarit përmes dijeve të tyre mbi teatrin.

---

<sup>2</sup> Vepër teatrore do të quhen të gjitha pjesët teatrore apo edhe punët e nxënësve, ku ata fillojnë me lojën dhe kulmohen me vënien në skenë të një pjese të thjeshtë dramaturgjike.

## II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit të mesëm të lartë.


Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së teatrit, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të integrohen lehtësisht në shoqëri.
- **Mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit**, për njohjen e rezultateve e pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara.
- **Hartuesit të teksteve mësimore** dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi i teatrit ka në thelbin të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet lëndës së teatrit është një përbërës i rëndësishëm i programit për kontributin e teatrit dhe të gjitha arteve të tjera, që përbëjnë fushën e arteve, në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu përshkruhet lidhja e teatrit me fushat e tjera në mënyrë që kurrikula e arsimit të mesëm të lartë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi përmban edhe tri tematika të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqiten edhe koha mësimore për secilën tematikë. Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie në teatër është kusht parësor për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik që zotëron brenda vetes. Në këtë program vlerësimi i nxënësve është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënësve. Programi i teatrit, nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

II.1.Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



## II.2. Qëllimet e APU

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi:

- të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria; të zhvillojë në mënyrë të pavarur e të gjithanshme;
- të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetën dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes.
- përdorë teknologjitë e reja.



### **II.3.Qëllimet e programit të teatrit**

Programi i teatrit, nëpërmjet përmbajtjes të përcaktuar sipas tematikave ka si qëllim të përforcojë e të zhvillojë më tej njohuritë dhe konceptet për edukimin dhe formimin artistik në teatër, të kuptuarit dhe të vlerësuarit e elementeve teatrore që na rrethojnë, zhvillimin e aftësive interpretuese, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve, aftësimin e nxënësve për të njohur dhe vlerësuar vepra të teatrit shqiptar dhe botëror, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike, përfshirjen në veprimtari teatrore tradicionale apo skenike, duke manifestuar vlerat e materialeve të interpretueshme kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke i vënë në shërbim të mjedisit ku jeton, aftësitë dhe talentin e vet, ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike, zhvillimin e kompetencave teatrore për të krijuar dhe realizuar pjesë të ndryshme të kësaj gjinie, dhënien e kontributit personal në zhvillimet artistike teatrore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Në programin e teatrit nxënësi thëllon kuptimin mbi ngjashmëritë e ndryshimet mes gjinive teatrore, natyrën shkak-pasojë të marrëdhënieve njerëzore, eksperimenton interpretimin nëpërmjet trupit dhe zërit të vet, hulumton punën në grup dhe kupton rëndësinë e ndërvarësisë nga njëri-tjetri. Ai kupton dhe argumenton qëndrimet e veta, duke ua paraqitur të tjerëve, mësohet të vlerësojë e të respektojë edhe qëndrimet e të tjerëve, arrin të krijojë siguri në komunikimin publik dhe të jetë bindës, madje të ndihet i suksesshëm në teatër.

Teatri do të mundësojë që nxënësi:

- të përjetojë dhe vlerësojë vlerat e teatrit si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, për ta ruajtur dhe për ta kultivuar identitetin kombëtar, si dhe duke zhvilluar aftësitë e përjetimit estetik, vlerësimit kritik dhe ndjeshmërisë;
- të përjetojë dhe vlerësojë teatrin e epokave të ndryshme sipas stilit, gjinive dhe zhanreve teatrore, duke zhvilluar aftësitë e përjetimit estetik, vlerësimit kritik dhe ndjeshmërisë;
- të zhvillojë aftësitë e bashkëpunimit dhe të krijimit të raporteve ndërmjet kulturave, duke ndërvepruar në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- të kuptojë forma të ndryshme të veprimtarisë teatrore duke zhvilluar aftësitë krijuese, individuale;
- të zhvillojë kompetencat teatrore për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme teatrore, punë të pavarur, duke krijuar përmbledhje nga vepra të ndryshme teatrore shqiptare apo të botërore;
- të marrë pjesë në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke vënë në shërbim të mjedisit ,ku jeton , aftësitë dhe talentin e vet;
- të japë kontributin personal në zhvillimet artistike teatrore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

#### **II.4.Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës**

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë, të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës/lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënies. Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Organizimi i mësimit të teatrit me bazë kompetencat përqëndrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Nxënësi duhet të ketë njohuri për karakteristikat kryesore të teatrit në epoka të ndryshme dhe për artistët më të shquar që u përkasin këtyre epokave. Gjithashtu, përmes përjetimit të veprave teatrore, ai duhet të dijë t'i vlerësojë krijimet teatrore dhe të përvetësojë kriteret për të dalluar shfaqjet estetikisht të mira dhe të vlefshme. Nëpërmjet leximit apo interpretimit të veprave të ndryshme skenike të dramaturgëve apo regjisorëve të shquar që nga antikiteti e deri te teatri i shekullit XX dhe përjetimeve të tyre, nxënësi duhet të dallojë stilin, gjininë, specifikat interpretuese, kostumet dhe karakteristika të tjera epokës në të cilën është krijuar vepra.

Duke zhvilluar kompetencat lëndore, nxënësi zhvillon edhe kompetencat kyçe në lidhje me *krijimtarinë, interpretimin, vlerësimin* e teatrit e letërsisë, përpunimin e informacionit për teatrin, prezantimin e detyrave të zhvilluara, punën në grup, komunikimin efikas, të folurën publike, etj. Rezultatet e të nxënësve të kompetencave lëndore, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë. Në zhvillimin e kompetencave lëndore nxënësi gjithashtu zhvillon kompetencat kyçe në lidhje me *krijimtarinë, interpretimin, vlerësimin* e teatrit e dramaturgjisë, përpunimin e informacionit për prezantimin e detyrave vetjake e në grup, komunikimin efikas etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së teatrit, mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënësve për kompetencat kyçe, që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxënësve për kompetencat kyçe për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënësve, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënësve për kompetencat e lëndës së teatrit që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxënësve për kompetencat e lëndës së teatrit për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënësve;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënësve të kompetencave teatrore në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënësve për kompetencat kyçe;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënësve;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënësve për lëndën e teatrit;

- stimulon nëpërmjet artit gjithëpërfshirjen edhe të atyre nxënësve që nuk arrijnë rezultate të larta akademike, por që shpesh tregojnë aftësi të veçanta në të tilla lloj aktivitete, duke qenë të çliruara nga ngurtësia akademike dhe të prirur për ta shfaqur pa frikë natyrën e tyre të vërtetë.

#### II.4.1.Diagrami 2: Rezultatet kryesore të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së teatrit.

<i><b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b></i>
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë teatrale e në analizimin e tyre;</li><li>- gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë konceptin teatror e filozofik të veprës;</li><li>- shprehet qartë dhe komunikon saktë estetikisht dhe artistikisht për vepra të ndryshme teatrale;</li><li>- komunikon dhe shprehet nëpërmjet mjeteve shprehëse teatrale në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.</li></ul>
<i><b>Kompetenca e të menduarit</b></i>
<p><b>Nxënësi :</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- përpunon njohuritë teatrale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</li><li>- zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me teatrin apo artin, në jetën e përditshme apo në klasë/shkollë;</li><li>- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese gjatë ndjekjes së një vepre teatrale;</li><li>- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim, projekt apo veprimtari teatrale artistike.</li></ul>
<i><b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b></i>
<p><b>Nxënësi :</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- vendos njohuritë teatrale në funksion të realizimit të një argumenti, krijimi apo projekti skenik/artistik;</li><li>- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një punë të vetën mbi artin në përgjithësi apo teatrin në veçanti;</li><li>- zhvillon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë, duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni.</li></ul>
<i><b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b></i>
<p><b>Nxënësi :</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt skenik;</li><li>- drejton aktivitetet teatrale brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.</li></ul>

### ***Kompetenca personale***

#### **Nxënësi :**

- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë veprimtarive teatrore/artistike;
- merr pjesë dhe kontribuon në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;
- zhvillon vetëbesimin tek aftësitë e veta dhe krijon lirshmëri dhe besim tek të tjerët në realizimin e detyrave artistike.

### ***Kompetenca qytetare***

#### **Nxënësi :**

- promovon me qytetari, vlerat të ndryshme kulturore dhe teatrore të vendit apo të krahinës;
- respekton punën dhe mendimin e të tjerëve lidhur me çështje artistike /teatrore;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

### ***Kompetenca digjitale***

#### **Nxënësi :**

- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet lidhur aspekte të ndryshme kulturore/teatrore;
- përdor /njeh mjete të ndryshme në funksion të informacionit teatrore si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

## **II.5.Lidhja e lëndës së teatrit me temat ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Teatri lidhet me një shumëllojshmëri të veprimtarive në jetën e përditshme dhe me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë, sepse ai jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; bashkëjetesa e kulturave dhe shkëmbimi midis tyre*, etj., nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve teatrore duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grup në aktivitete të ndryshme, duke dhënë kontributin e vet, duke u dhënë zgjidhje situatave dhe


problemeve të ndryshme teatrore/artistike, duke përdorur gjuhë të saktë teatrore për të komunikuar vlera dhe qëndrime, duke shpjeguar teknika dhe procese të ndryshme skenike, që lidhen dhe me fusha të tjera që ata mësojnë. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave teatrore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi përdor aftësitë e tij teatrore që kanë të bëjnë me simbole, konvencione skenike, kostumografi e rekuizitë, duke krijuar një marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë elementet e një shfaqjeje skenike, çfarë tiparesh teatrore ka jeta e tyre dhe ndërvarësitë e mjedisit dhe botës njerëzore (loja, rituali, marrëdhëniet njerëzore, shkak-pasojë).

Teatri është domosdoshmërisht i lidhur me lëndët brenda fushës së tij, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikula. Elementet teatrore si interpretimi, skenografia, teatri, kostumet, ndriçimi, etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si kërcimi, arti pamor, teatri, por edhe me letërsinë, gjuhën, shkencat shoqërore, biologjinë, fizikën, etj.

Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të teatrit me lëndë të tjera, të para përmes objektivave të njohurive:

### II.5.1. Diagrami 3: Lidhja e teatrit me fushat e tjera





## **II.6.Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj**

Bazuar në kurrikul, lënda e teatrit synon të përmbushë 3 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe, që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore.


### *Kompetencat e lëndës:*

- krijimi i veprave teatrore;
- interpretimi i veprave teatrore;
- vlerësimi i veprave teatrore.

### *Tematikat e lëndës:*

- gjuha dhe komunikimi teatror;
- teknikat dhe proceset teatrore;
- historia, teatri dhe shoqëria.

II.6.1. Diagrami 4 : Kompetencat që formohen përmes tematikave



**II.6.2.Tabela 1: Kompetencat e veçanta dhe përshkrimi i tyre**

Kompetencat e veçanta	Përshkrimi i kompetencave
<b>Krijimi i veprave teatrore</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon mendimin e tij personal mbi elementet teatrore dhe estetike gjatë analizimit të veprës teatrore;</li> <li>- organizon opinionin e vet sipas mjeteve shprehëse të teatrit dhe mendimit estetik;</li> <li>- përdor ide të ndryshme për të organizuar dhe qartësuar mendimin ose mesazhin që përcjell vepra teatrore;</li> <li>- ndan përvojat e veta teatrore me të tjerët.</li> </ul>
<b>Interpretimi i veprave teatrore</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përjeton emocionalisht gjatë procesit të interpretimit të një vepre, duke dhënë qartë mesazhin që përcjell vepra;</li> <li>- interpreton veprën duke dhënë emocionet e karakterit të veprës sipas <i>autorit dhe periudhës</i> në të cilën është realizuar vepra;</li> <li>- bën krahasimin e veprave teatrore, duke përdorur elementet e ndryshëm specifik;</li> <li>- interpreton mendimin e vet mbi përmbajtjet teatrore të pjesëve të parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të saj;</li> <li>- ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë.</li> </ul>
<b>Vlerësimi i veprave teatrore</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon gjykimin dhe mendimin krijues të mendimit teatror dhe estetik;</li> <li>- analizon veprat teatrore që nga antikiteti e deri në ditët tona;</li> </ul>

- vlerëson veprat teatrale, sipas autorit, veprës dhe periudhës në të cilën është realizuar vepra, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.

## II.7. Koha mësimore për tematikë

Lënda e teatrit në arsimin e mesëm të lartë, zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje të detyruar. Ajo zhvillohet për 36 javë mësimore me nga 2 orë, pra gjithsej 72 orë. Programi i lëndës së teatrit specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

**II.7.1. Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

Tematikat	Gjuha dhe komunikimi teator	Teknikat dhe proceset	Historia, Teatri dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa e dhjetë	10	32	30	72 orë

### **III. Përmbajtja sipas tematikave të lëndës**

Në programin e lëndës së teatrit, janë paraqitur përmbajtjet e tematikave të teatrit:

- *gjuha dhe komunikimi teatror;*
- *teknikat dhe proceset e interpretimit;*
- *historia, teatri dhe shoqëria.*

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar e njohuri, shkathtësi dhe qëndrime e vlera, për të siguruar rezultatet e të nxënit sipas kompetencave teatrore, për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike. Për secilën tematikë, janë paraqitur njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse.

Kombinimi, ndarja e njohurive dhe koncepteve teatrore në situata të nxëni, grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (mësuesit dhe autorët e teksteve).

Për “përkthimin” e programit në tekste mësimore apo programe lëndore, aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në tematika dhe njësi mësimore të zhvilluara logjikisht.

### **III.1. REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE SIPAS TEMATIKAVE**

#### **KLASA E DHJETË -DYMBËDHJETË**

##### **III.1.1. Tematika: Gjuha dhe komunikimi teatror**

###### **PËRSHKRIMI I TEMATIKËS**

Teatri dhe shumë çështje të tij trajtohen përmes studimit të zhvillimit të mendimit teatror, estetik dhe gjuhës teatrore. Të gjitha këto trajtohen nëpërmjet studimit të artit në përgjithësi dhe tipareve të përbashkëta të arteve midis tyre, çfarë përfaqëson teatri dhe cilat janë mjetet shprehëse, elementet teatrore me të cilat krijohet, interpretohet dhe studiohet teatri. Janë format dhe gjinitë teatrore, epokat historike dhe stili i autorëve të cilat, nëse arrijmë t'i mësojmë dhe shpjegojmë, arrijmë të kuptojmë të bukurën në teatër, të komunikojmë përmes një gjuhe teatrore korrekte, gjë që kërkon një njohje të elementeve dhe parimeve të formësimit të teatrit për ta kuptuar, analizuar, vlerësuar, interpretuar dhe gjykuar mbi një vepër të caktuar teatrore.

Të mos harrojmë që nxënësi ka pasur kontakte më të hershme me teatrin në shkallë më të ulëta arsimore, pra tani kemi të bëjmë me thellimi të njohurive mbi elementet teatrorë e kombinimin e tyre në skenë, që do të çojnë në edukimin e nxënësve me interpretimin, paraqitjen skenike, të folurit publik dhe të qenët bindës në rolin e tyre para publikut. Nxënësit, përveç se zhvillojnë ndjenjën e përdorimit të imagjinatës e aftësive vetjake përmes përjetimeve konkrete interpretuese, zhvillojnë edhe aftësinë për ta paraqitur lojën skenike. Procese të tilla si: zbulimi, përjetimi, dëgjimi, analizimi, interpretimi apo çfarëdo krijimi i lidhur me gjuhën teatrore ndihmon nxënësit të zhvillojnë jo vetëm kompetencën e krijimit, por edhe të zbatimit konkret të gjuhës teatrore në pjesë teatrale e analizimin kompetent të një vepre teatrore. Pavarësisht se cila do të jetë pjesa që do të vendoset të interpretohet (që do të jetë një pjesë shqiptare e vendosur mbi bazë argumenti “pro” e “kundër” pas diskutimeve të ndryshme midis mësuesit e nxënësve, që do të jenë pjesë e saj), në këto orë nxënësit do të njihen edhe një herë, tashmë në mënyrë të përmbledhur me mbarë historinë e teatrit botëror e shqiptar dhe do të

konsiderojnë për të vënë në skenë pjesë të dramaturgjisë botërore apo shqiptare të sugjeruara nga mësuesi ose të hulumtuara nga ata vetë, çka do të ndihmojë që të zhvillohen biseda të rrjedhshme mes mësuesit e nxënësve mbi këto pjesë, duke e ndihmuar arsimtarin të shpalosë veçoritë e gjinisë, të stilit, të tematikës, të epokës historie e rrethanave shoqërore, kombëtare etj., që do të sjellë jo vetëm përgatitjen e terrenit për teknikat teatrore që do të vijojnë, por do të thellojë edhe njohuri të bazuara të nxënësit mbi të gjitha këto tipare të dramaturgjisë shqipe në veçanti dhe parimet e saj universale në përgjithësi.

## REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS

### *Krijimi teatror:*

- njeh me saktësi kuptimin e formave dhe gjinive teatrore;
- komunikon mendimin e vet për vepra të ndryshme teatrore, duke përdorur një gjuhë të saktë;
- zhvillon idenë rreth të bukurës në teatër përmes mendimit estetik;
- ndan përvojat e veta teatrore me të tjerët.

### *Interpretimi teatror:*

- interpreton idenë e vet përmes një gjuhe të saktë, për një vepër të caktuar teatrore;
- interpreton ndikimin dhe pasqyrimin e historisë në teatër e anasjelltas, duke dhënë shembuj konkretë;
- përjeton vepra të ndryshme teatrore nga ana emocionale dhe interpreton përjetimin e vet emocional përmes esesë, vizatimit ose fjalës;
- interpreton ndryshimin e gjendjeve emocionale gjatë ndjekjes së veprave të ndryshme teatrore;
- shpjegon qartë kuptimin e formës teatrore, gjinisë dhe stilit teatror.

### *Vlerësimi teatror:*

- evidenton praninë e teatrit në jetën e përditshme dhe e vlerëson atë;
- formulon ide të ndryshme rreth artit dhe teatrit duke shprehur mendimin e vet rreth përjetimit emocional;
- vlerëson përmes përjetimit një vepër teatrore, të gjinisë dhe stilit teatror.

### Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

### Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

#### KLASA X-XII

#### Gjuha, mendimi dhe komunikimi teatror:

- Arti, teatri dhe mendimi estetik.
- E bukura në art dhe në teatër.
- Vepra teatrore dhe dramaturgu.
- Mjetet shprehëse në teatër.

#### Elementet teatrore:

- Interpretimi.
- Zhanri.
- Elementet skenike.
- Karakteri kombëtar e universal i veprës.
- Etydi.

#### Lidhja e ngushtë e tatarit me rrethanat historike e shoqërore.

#### Nxënësi/ja:

- hulumton pjesë dramaturgjike të teatrit shqiptar e botëror, duke krijuar mbi to argumentim tematik, estetik, historik dhe shoqëror;
- diskuton rreth veçorive që karakterizojnë dramaturgjinë shqipe, gjinitë e lëvruara të saj;
- përshkruan gjendje të ndryshme emocionale, përballë pjesëve të ndryshme;
- evidenton skenat jetësore dhe konvencionin në veprën dramaturgjike;
- shpjegon rolin e mjeteve *shprehëse teatrore*, bazë në kuptimin dhe realizimin e një vepre teatrore;
- përshkruan dhe diskuton mbi ndryshueshmërinë e emocionit që krijojnë në një vepër *elementet teatrorë*;
- shpjegon *parimet e krijimit të karakterit dhe elemente të tjera skenike që lidhen me plotësimin e figurës*;
- kupton *strukturën teatrore* të ndërtimit të një vepre dhe jepi mendimin e vet mbi vendosjen e saj në skenë, si një krijim origjinal;



**Simbolizmi dhe konvencioni në teatër.**

**Gjinitë teatrore.**

**Stili teatror.**

- shpjegon kuptimin e *formës teatrore, gjinisë dhe stilit*;
- formulon pyetje rreth veprave teatrore nga kohë të shkuara ose të tanishme, lidh epokat me krijimet teatrore;
- evidenton elementet tipike kombëtare në një pjesë dramaturgjike shqiptare ose jo dhe ato universale.

### III.1.2. Tematika: Teknika dhe procese teatrore

#### PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Interpretimi i një pjese kërkon së pari interes në arsyen pse përzgjidhet ajo. Në fazën e parë, mësuesit e nxënësit kanë argumentuar mbi rrethanat historike e shoqërore të pjesës që kanë përzgjedhur, mbi gjininë e saj, llojin e dramaturgjisë që përfaqëson, etj. Në këtë fazë, teksa fillojnë ta vënë në skenë, ata hulumtojnë më tej me konceptin regjisorial që kanë zgjedhur dhe në bazë të tij fillojnë të ndërtojnë etydet, të krijojnë siluetat e personazheve, marrëdhëniet në skenë mes tyre, nëntekstet e atyre çka thonë, ashtu siç fillojnë të mendojnë për stilin e kostumeve, skenografisë, rekuizitave, ndriçimit e muzikës, që të gjitha në varësi të zhanrit të dramaturgjisë, ose nëse nuk i kanë qëndruar besnik pjesës, por kanë krijuar një koncept regjisorial krejt të pavarur, të përkojnë me këtë të fundit. Duhet mbajtur parasysh se ka nxënës, që më shumë se të prirur për të interpretuar e duan teatrin prej vizioneve regjisoriale që kanë apo thjesht nuk janë të aftë të interpretojnë, por të realizojnë elemente të tjera të shfaqjes (kostumet, muzikën, skenografinë) duhet bërë kujdes që këta nxënës, pavarësisht se nuk luajnë rol skenik, të nxiten të zhvillojnë vizionin e tyre artistik në këtë aspekt që është gjithaq i rëndësishëm sa edhe interpretimi skenik. Të mos harrojmë edhe një herë që nxënësi vjen me dije më të hershme e më të përcipta të teatrit, nga shkallë të hershme, ndaj tani prej tij pritet punë e pavarur në thellimin e disa koncepteve, në mënyrë që diskutimi me mësuesin të jetë e një niveli bashkëbisedimi e jo thjesht direktiva nga mësuesi. Kjo do të sjellë jo vetëm zhdërvjelltësi të mendimit të nxënësit e siguri të tij, por edhe

një përjetim më të mirë, si një punë e mundimshme, por e shpërblyer në përfundim të shfaqjes. Kënaqësitë dhe vështirësitë e këtyre projekteve u mësojnë nxënësve vlerat e ndërmarrjes së një projekti dhe përfundimi i tij me vullnet të lirë, drejt një fundi të suksesshëm: një aftësi mjaft e nevojshme kjo në të ardhmen e tyre.

## REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS

*Krijimi teatror.*

*Nxënësi :*

- bën rolin e regjisorit/skenografit/kostumografit në një pjesë të plotë teatrore;
- interpreton saktë detyrën sipas *zhanrit, epokës, konceptit regjisorial*;
- bën krahasimin e pjesëve teatrore që interpreton, duke përdorur elementet dhe parimet e formësimit teatror.

*Interpretimi teatror.*

*Nxënësi:*

- interpreton idetë e veta, duke komunikuar artistikisht dhe estetikisht mbi një vepër teatrore;
- sjell një kuptim të qartë të pjesës teatrore sipas autorit, veprës dhe periudhës në të cilën është realizuar vepra;
- ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë.

*Vlerësimi i veprave teatrore:*

*Nxënësi:*

- vlerëson interpretimin e veprave të ndryshme teatrore;
- përjeton dhe vlerëson interpretimin artistik, duke zhvilluar gjykimin mbi këto vepra;
- reflekton emocionet që i krijon një vepër skenike gjatë kohës që interpretohet.

**Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës**

**Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**

## KLASA 10 -12 -të

- **Gjinia e pjesës.**
- **Krijim sipas konceptit regjisorial.**
- **Rolet dhe karakteristikat e tyre.**
- **Ndërtimi i marrëdhënieve skenike.**
- **Të dëgjuarit dhe vëmendja skenike.**
- **Etydi.**
- **Loja në ansambël.**
- **Nënteksti.**

Nxënësi/ja:

- interpreton vetëm dhe në ansambël;
- propozon rolin që dëshiron sipas prirjeve vetjake, ashtu si edhe pranon e bën të pamundurën të realizojë një rol të caktuar nga regjisori/mësuesi, sipas vizionit të këtij të fundit;
- hulumton mbi rolin e caktuar dhe e analizon atë, duke propozuar veçori të personazhit, që ta realizojë në mënyrë më të plotë e krijuese (nëse personazhi mund të interpretohet si çalaman, shumë i shëndoshë, gagaç, zëhollë, etj.);
- interpreton tekstin, krijon etyde dhe marrëdhënie sipas karakteristikave të personazhit të tij, në pajtim me regjisorin/mësuesin dhe pjesën tjetër të trupës interpretuese;
- dëgjon dhe komenton interpretimin e pjesëtarëve të tjerë;
- përpiqet të punojë në ansambël, duke krijuar marrëdhënie të qëndrueshme skenike, pa mbytur lojën e të tjerëve me të tijën, por edhe pa rrëzuar ritmin e pjesës;
- improvizon lirshëm, për të përmirësuar etydet që krijojnë shfaqjen, duke sjellë më shumë krijimtari mbi të;
- përpiqet të mos harrojë arritjet e çdo prove, duke ruajtur stabilitetin e punës e duke e ndihmuar atë të zhvillohet më tej.

### III.1.4 Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria

#### PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Ashtu siç përmendëm shkarazi tek gjuha dhe komunikimi teator, nxënësi njihet edhe një herë me historinë e teatrit botëror e të dramaturgjisë shqipe. Ajo kalon nga teatri klasik grek (600 p.e.s. - 600 e.s.), me zhvillimin e komedisë e tragjedisë klasike, me pjesë të Eskilit, Euripidit, Sofokliut, Aristofanit, për të vazhduar me teatrin romak, që përveç satirës shtoi edhe forma të reja teatri si pantomima, farsa dhe spektakli (përfshirë edhe gara me gladiatorë, me pjesë të Plautit, Homerit dhe Ovidit). Pastaj vjen dramaturgjia mesjetare, rëndom e panjohur në Shqipëri, pasi karakterizohet nga dramaturgjia liturgjike dhe viheshin kryesisht në kisha. Tre lloje dramash spikatin në këtë kohë: Dramat e misterit, mbështetur mbi episode të Biblës; Pjesët e mrekullive, bazuar mbi jetët e shenjtoreve e martirëve; Pjesët e moralit, ku virtytet triumfojnë mbi veset (Anoni). Në vitet 1500-1650 lulëzon teatri i Rilindjes, i cili karakterizohet nga 3 lloje dramaturgjie: Tragjeditë e hakmarrjes, ku emrat më në zë janë Shekspiri, Tërneri, Marlou, Ford, Uebster; nga komedia elizabetiane e jakobine të Shekspirit, Xhonsonit, etj. dhe *Commedia Dell Arte*, që filloi e u zhvillua në Itali në shekullin e XVI me autorë si Goldoni. Periudha e Përtëritjes (1650-1700) e shikonte shoqërinë nga një këndvështrim satirik dhe ajo që nisi me skandalet morale të oborrit me pjesë të Molierit, Goldsmithit, Kongrevit, Sherdanit, u perfeksionua në komedinë e cilësuar si të lartë e intelektuale të Oskar Uajlldit e Noel Kauardit. Romanticizmi (1800-1850) karakterizohet nga melodramat e Anonit, po edhe me reagime ndaj rregullave të ngurta të neoklasicizmit me autorë si Gëtja e Shileri. Shekulli i XX-XI janë tejet të larmishëm, duke filluar me realizmin e natyralizmin e dramave të Ibsenit, Çehovit, Strindbergut, Shout, Gorkit, Priestlit, etj. Simbolizimi sfidoi realizmin e natyralizmin me veprat e Pirandelos, Lorkës, Eliotit, kurse ekspresionizmi ishte një lëvizje që lindi në Gjermani para Lufta e Parë Botërore e përfundoi në vitet

'20, e cila u përpoq të shkatërronte idetë sipërfaqësore të realitetit, për të eksploruar kuptime më të thella nën të, me emra si Strindberg, Büchner, Vedekind. Surrealizmi rishikoi përcaktimin e realitetit në veprat e Zharisë e Koktosë. Teatri i absurdit u ndikua nga Kamyja dhe pati përhapje të gjerë me vepra të Joneskos, Beketit, Xhenetit, Stopardit, Sartrit, etj, për t'u ndjekur nga *Pinteresque*, që përziën realizmin me teatrin e absurdit, përfaqësuar me Stori e Pinter. Teatri epik kërkonte një publik hetues, kritik e objektiv dhe përfaqësohet nga emra si Breht, Dyrrenmat, Litëllud, kurse teatri politik thekson fabula ose tema politike dhe ndër emrat më në zë që e përfaqësojnë janë Brehti, Brentoni, MekGrethi, Grifits, Arden. etj. Teatri politik italian, shpesh është i ndaluar e i censuruar se merret me temat e pozicionimit të grave e sidomos fenë katolike, duke dalë kështu përtej territorit të vendit e duke u bërë universal paçka se ngrihet mbi skicat e *Commedia Dell'Arte* dhe natyrisht që emri më në zë i tij është Dario Fo. Pas rrymave më pak të përhapura si Dokudrama (Hejër, Soans) dhe Teatrit fizik (Berkof), fuqizohet teatri feminist që përqendrohet tek vendi dhe trajtimi i femrave në shoqëri, me emra të mirënjohur si Çerçill, Tounsend, Kitli. Kohët e fundit na vjen teatri që ta përplas në fytyrë, haptazi agresiv e provokues, me emra si Rejvënhill, Kejn, Marbër, Pritçërd, etj.

Nuk duhet të harrojmë dramaturgjinë irlandeze me emra të spikatur si MekDonag, MekFëron, Behan, etj., komedinë e zezë të Orton e Nikolls; farsën, që ishte veçanërisht popullore në Francën e shekullit XIX, por jo vetëm (Stopard, Frein. Orton, Konei), dramaturgjinë amerikane, me stilin e saj unik e emra si Uilliams, Miller, O'Nill, Mame.

Për sa i përket dramaturgjisë shqiptare, kalojmë pjesët që na vijnë nga rilindja, duke kaluar nëpër komunizëm e mandej në dramaturgjinë bashkëkohore shqipe. Natyrisht që nxënësi di diçka të përciptë nga mësimet e hershme, por tani ai hulumton me prindërit, në internet ose në libra për të sjellë materiale rreth kësaj dege të teatrit e dramaturgjisë. Për shkak të vëllimit jo shumë të lartë të pjesëve, faza e parë në Shqipëri përfshin dramaturgjinë e Rilindjes, gjer në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, kryesisht me dramaturgji mbi nderin kombëtar, pjesë epike historike apo nga ato të bazuara mbi motivet e kanunit, për të përçarur besën si vlerë kombëtare, në kohëra kur kërcënimi territorial i Shqipërisë kërkonte që të gjendeshin të mirat e përbashkëta që na bashkojnë prej shekujsh. Përveç "14 vjeç dhëndër", "Pas vdekjes", "Martesa e avokatit" e disa komedive të tjera nga Kristo Floqi që sulmonin disa tipare shoqërore, pjesa tjetër

ishin kryesisht drama historike apo epike. Periudha e komunizmit karakterizohet nga 2 faza kryesore: faza e parë gjer nga fundi i viteve 70 ishin kryesisht pjesë propagandistike, që dënonin zakone e mendësi të vjetra, si në lëmin e dramës historike, ashtu edhe në atë të komedisë, duke himnizuar rendin e njeriut e ri. Diku nga fundi i viteve '70, mesi i viteve '80, filloi të lëvrohej më gjerësisht drama e komedia sociale, ku piketoheshin e sulmoheshin më shumë dramet apo cenet e njeriut në shoqëri, se sa tematikat e mëdha propagandistike, që gjithsesi nuk u shuan krejt. Kjo solli një natyrshmëri më të madhe dramaturgjike dhe një afrim me problematikat e ditës, që gjithsesi e kishin një dozë propagande brenda. Pas rënies së komunizmit dramaturgjia shqipe u gjend në rrethana fort të vështira: dramaturgët duhet të kapërdinin gjithë këtë ndryshim të madh e trazira të vazhdueshme, pastaj u ndje një krizë e thellë nga përballja e tyre me dramaturgjinë botërore, prej së cilës ishin të izoluar për shumë vite me radhë dhe faza të përparuara ku kishte mbërritur teatri modern, çka solli një hendek të madh me atë që ishte bërë në teatër deri tani.

U sollën plot drama me tematika nga e shkuara ose problematika bashkëkohore, por prapë dramaturgjia shqipe ishte ende me një këmbë në dramaturgjinë e së kaluarës e me tjetrën që përpiqet të kapë tendencat bashkëkohore. Më në fund, pas 25 vjetësh, dramaturgë të një brezi të ri po i sjellin një frymëmarrje dhe një identitet të ri dramaturgjisë bashkëkohore shqiptare. Të gjitha këto, nxënësit duhet t'i hulumtojnë gjatë kohës që argumentojnë mbi përzgjedhjen e pjesëve dhe kontekstin e tyre historik e shoqëror, prej nga do të nxjerrin rolin e dramës në shoqëri e histori dhe ndikimin e saj tek publiku. Nuk duhet harruar të kundrohet edhe drama kosovare.

Pjesë shqiptare që mund të merren në diskutim dhe të konsiderohen për t'u vënë në fund të shkallës (njëra prej tyre) mund të jenë: *"14 vjeç dhëndër"*, *"Martesa e Avokatit"*, *"Toka Jonë"* (që pas shpjegimit të rrethanave reale historike e shoqërore, sot mund të provohej të vihej në skenë si një komedi absurde e luajtur me shumë seriozitet), ose *"Shi në plazh"*, *"Gjaku i Arbrit"*, *"Allegreto Albania"*, etj. (nëse ka më shumë nxënës se role, vihen dy pjesë ose shfaqja, vihet me dublantë).

## REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS

### *Krijimi teatror*

#### ***Nxënësi :***

- përjeton emocionalisht një vepër teatrorë dhe krijon ese për të shprehur gjykimet e veta;
- shikon online pjesë të ndryshme të dramaturgjisë shqipe dhe krijon koncepte të qarta mbi teatrin shqiptar në vite;
- diskuton me prindërit e të afërmit për përjetimet e lidhjet e tyre me teatrin në rini;
- përzgjedh njërën dhe e sjell në klasë me gjithë hulumtimin që ka bërë për të, duke krijuar kështu të gjithë së bashku një dosje me një mori veprash të dramaturgjisë shqiptare dhe duke mësuar prej tyre në mënyrë aktive.
- krijon opinion dhe gjykimin e vet artistik duke u nisur nga karakteristikat e periudhës në të cilën u krijua vepra teatrorë;
- ndan gjykimin e vet për një krijim teatror me të tjerët.

### *Interpretimi teatror*

#### ***Nxënësi :***

- interpreton nga ana artistike dhe estetike domethënien e një veprë teatrorë;
- interpreton të dhëna, fakte dhe kuriozitete për të nxjerrë në pah rëndësinë e zhvillimit të formave teatrorë në periudha të ndryshme.

### *Vlerësimi i veprave teatrorë*

#### ***Nxënësi :***

- bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi teatrin dhe asaj që studion, duke ndarë informacionet;
- bën gjykime kritike ndaj një veprë teatrorë, duke u mbështetur në elementet e gjuhës teatrorë formën teatrorë, karakterin e

pjesëve teatrore;

- komunikon dhe shpreh përjetimin e vet emocional rreth veprave teatrore të dëgjua sipas karakteristikave historike, politike, gjeografike, kulturore, fetare që ndikuan në zhvillimin e kulturës teatrore në periudha të ndryshme;
- ndan përvojën/mendimin e vet artistik me të tjerët dhe respekton mendimin e shokëve;
- prezanton punën e vet përmes mediave dhe teknologjive të ndryshme;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

### Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

### Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

#### KLASA X-XII

#### Kultura teatrore:

- Zhvillimi i saj, sipas karakteristikave të periudhës, veprave dhe dramaturgëve.
- Zhanret, karakteristikat
- Stilet, karakteristikat
- Dallimet mes një zhanri në periudha të ndryshme
- Kontekstet shoqërore e historike
- **Zhvillimi i dramaturgjisë e teatrit shqip:**
- Format dhe stili teatror: drama historike, epike, romantike, komedia shoqërore.
- Vlerat kombëtare dhe karakteri tipik shqiptar në dramaturgjinë shqipe.

#### Nxënësi/ja:

- analizon rrugën që ka ndjekur zhvillimi i dramaturgjisë shqipe në periudha të ndryshme.
- shpjegon karakteristikat *historike, politike, kulturore, fetare, kombëtare* që ndikuan në zhvillimin e kulturës teatrore në periudha të ndryshme.
- evidenton *format teatrore* sipas karakteristikave të tyre dhe shpjegon problematikën që trajton secila.
- argumenton zhvillimin e *formave teatrore* në periudha të ndryshme.
- shpjegon rrugën e zhvillimit të gjinive teatrore në Shqipëri
- prezanton informacionin e mbledhur rreth *teatrit* gjatë këtyre periudhave të marra në studim.
- realizon një projekt mbi jetën dhe veprën e një dramaturgu apo veprë dramaturgjike të një periudhe të caktuar.



- Mesazhet universale.
  - Propaganda mbi sistemin komunist dhe njeriun e ri, tjetërsimi i simboleve teatrale e kodeve kombëtare në funksionon të kësaj propagande.
  - Drama dhe komedia e mëvonshme shoqërore, mesazhet e problematikës së ditës, por edhe mesazhe universale, që janë mungesë e periudhës së parë të krijimtarisë.
  - Tiparet e reja dhe trashëgimia nga e shkuara.
  - Problemet me trajtimin e fenomeneve, përpjekja për të gjithëpërfshirë këto të fundit dhe artificialiteti që sjell në dramaturgjinë e re.
  - Dramaturgët modernë dhe gjuha e re dramaturgjike, motive kombëtare si frymëzim për mesazhe universale.
- përdor mjete të ndryshme të teknologjisë për:
    - kërkim të dhënash;
    - prezantim;
    - regjistrime audio dhe video.

## QËNDRIME DHE VLERA

### Nxënësi :

- dëgjon dhe shpreh mendimin e vet të bazuar në njohuritë teatrale mbi format, gjinitë dhe stilet teatrale;
- shpjegon emocionin e krijuar nga veprat teatrale përmes përjetimit të tyre konkret;
- shpreh idetë e veta për teatrin që dëgjon;
- komunikon dhe shprehet artistikisht për një pjesë teatrale;
- demonstroi vetëbesim në aktivitete të ndryshme teatrale/skenike;

- komunikon në mënyrë të pavarur, duke argumentuar qartë mendimin e vet;
- merr pjesë aktive në veprimtaritë teatrore vetëm dhe në grup;
- përdor imagjinatën për të krijuar ose interpretuar mendimin mbi teatrin dhe veprat teatrore;
- krijon vetëbesim gjatë prezantimit të punëve të veta;
- bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari teatrore/projekt të përbashkët;
- respekton diversitetin ndaj qëndrimeve e koncepteve të ndryshme teatrore që dëgjon, përjeton apo njih;
- respekton krijimet e veta dhe të tjerëve;
- zhvillon një gjykim të saktë ndaj veprave të ndryshme teatrore që dëgjon, pavarësisht karakteristikave *historike, politike, kulturore, fetare* që ndikuan në zhvillimin e kulturës teatrore në periudha të ndryshme;
- interpreton duke treguar njohje shumë të mirë të kulturës kombëtare apo të kulturave të tjera;
- zhvillon frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë proceseve të ndryshme artistike;
- përqendrohet dhe tregon durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

#### **IV.Udhëzime metodologjike**

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënimit të teatrit është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të teatrit do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, të përjetojnë dhe provojnë vetë dukuritë dhe fenomenet teatrore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar e cila arrihet nëpërmjet rezultateve të të nxënimit dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e teatrit, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike jo gjithmonë krejtësisht të vetëdijshme për nxënësit e kësaj grupmoshe. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore teatrore është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia e teatrit synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e teatrit mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënit në teatër;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie të mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë skenike;
- rëndësinë e zbatimeve praktike skenike, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet e komunikimit e të kuptuarit në situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve teatrore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- veçoritë e interpretimit në mënyrë individuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së teatrit dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e menduar dhe e planifikuar siç duhet krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat teatrore janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënit që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive

të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në teatër.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si: “Pse më pëlqen?”, “A është vënë në skenë siç duhet?”, “A është interpretuar mirë?” etj. Në këtë mënyrë ai nxitet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja. Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integrale me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre, janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave skenike/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

#### **V.Udhëzime për vlerësimin**

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënës bazuara në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive skenike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (***p.sh. vetëvlerësimi, interpretim i një sërë materialesh, portofol me punë artistike, prezantim me gojë, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.***)

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në teatër, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale, por të bashkërenduara në një punë finale grupi. *Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënimit dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave teatrore të nxënësve, përmes krijimit, interpretimit dhe vlerësimit. Arritjet në fushën e teatrit dhe të arteve janë si individuale ashtu edhe në kontributin e tyre të punës në ansambël, prandaj duhet edhe të vlerësohen në të dyja aspektet.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes *të interpretuarit, të krijuarit, të analizuarit të pjesëve artistike* etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Dosja e nxënësit është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në teatër. Ai mund të përmbajë krijime dhe projekte kurrikulare, prodhime të ndryshme në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

## **VI. Materiale dhe burime mësimore**

Gjatë mësimin të teatrit, për realizimin e kompetencave mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Mësuesi përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në këtë fushë duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë shfaqje, muzikë, metoda si të bëjnë diçka, elemente artistike, informacione për teatrin, materiale letrare, duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e teatrit. Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër, por të thjeshtë të gjuhës teatrore. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai u prezanton/sqaron nxënësve përmbajtje të caktuara ose shkathtësi që ata duhet të interpretojnë. Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të mediave detyra dhe projekte të ndryshme.

Teatri studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve si shikim të shfaqjeve, kërkimi për elemente të nevojshme, që kërkon shfrytëzimin e mediave të ndryshme, TV, pajisje digjitale si kompjuterët, etj. Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet natyrore si:* vetë trupi i njeriut, zëri, etj.

- *Mjetet audio-vizuale si:* TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, katalogë, libra jashtëshkollorë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme teatrore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për teatrin. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe interpretuese, si dhe në kryerjen e krijimeve të ndryshme.
- *Mjedisi mësimor si:* (klasa, studio pune, ambient interpretimi etj.).